



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KRM 'PASTËRTIA', PËR VITIN 2025

Prishtinë, prill 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të KRM 'Pastërtia', për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të KRM 'Pastërtia', (Sh.A), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të KRM 'Pastërtia', deri me 31 dhjetor 2025, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- B1 Ndërmarrja në pasqyrat financiare të vitit 2025, kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,375,357€. Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018.
- A1 Ndërmarrja ka paraqitur 3,207,724€ si rezervë tjetër në pasqyra financiare pa evidencë të mjaftueshme. Ky zë përfshin transaksione që nuk janë të natyrës së rezervave tjera (si tatime, provizione, falje borxhesh).
- B2 Ndërmarrja që nga viti 2018 e këndeje nuk kishte bërë vlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi identifikuar se në regjistrin kontabël të pasurive janë të përfshira një numër i konsiderueshëm prej 99 pasuri me kosto historike në shumën prej 1,094,384€ dhe që janë të zhvlerësuar në tërësi, pra vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0). Edhe pse këto pasuri janë ende aktive, nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 7 vitesh.
- A2 Ndërmarrja ka paraqitur në pasqyrat financiare për vitin 2025 detyrime afatshkurtra në vlerë prej 121,006€. Megjithatë, këto shuma lidhen me konteste gjyqësore ende të pazgjdhura dhe nuk përfaqësojnë detyrime të konfirmuara në bazë të një vendimi përfundimtar të gjykatës.
- C1 Ndërmarrja obligimet tatimore kishte nën vlerësuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 në shumën prej 108,465€, duke mos reflektuar gjendjen e saktë të borxhit tatimor ndaj ATK-së.
- A3 Pasuritë e prekshme dhe të paprekshme, për 6 mostra të testuara në vlerë totale prej 89,169€, nuk janë mbështetur me dëshmi të mjaftueshme, pasi këto dëshmi nuk janë siguruar, dhe për rrjedhojë nuk kemi qenë në gjendje t'i verifikojmë dhe t'i paraqesim nëse gjendja e tyre është e saktë në pasqyrat financiare.
- A4 Fitimet e mbajtura në vitin 2025 janë të pasakta për shkak se në vitin 2024 është paraqitur shpërndarja e dividendës prej 86,011€ pa vendim dhe dokumentacion mbështetës, e përdorur si shifër balancuese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në kapitullin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të KRM 'Pastërtia', nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A5 Ndërmarrja nuk ka lidhur kontrata të formalizuara me 25 konsumatorë që përfitojnë shërbime grumbullimi dhe menaxhimi të mbeturinave. Për më tepër, 14 konsumatorë të regjistruar në regjistrin e llogarive të arkëtueshme nuk ishin të identifikuar me emër.
- A6 Raporti i inventarizimit ishte përgatitur nga komisioni, por nuk ishte bërë harmonizimi i tij me evidencat kontabël.
- A7 Bordi i Drejtorëve vazhdoi mandatin e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Sekretarit pa procedurë të hapur rekrutimi, ndërsa për pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv kandidati nuk i plotësonte kriteret e përvojës menaxheriale.
- A8 Ndërmarrja nuk ka zhvilluar rekrutim të rregullt për pozitën e zyrtarit të prokurimit, por ka angazhuar një person përmes kontratës për shërbime si dhe zyrtarja e auditimit të brendshëm është emëruar me vendim të menaxhmentit dhe nuk posedon çertifikim profesional si auditore e brendshme.
- A9 Ndërmarrja në pasqyrat financiare kishte prezantuar obligime ndaj kontributeve pensionale në vlerë prej 228,649€ dhe obligime ndaj tatimit në paga në vlerë prej 132,030€. Obligimet e tilla ndërmarrja nuk i kishte paguar sipas afateve ligjore.
- A10 Ndërmarrja nuk ka të vendosur në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregullorja MF -01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Ndërmarrja, nuk ka miratuar planin e biznesit, politika dhe procedura kontabël dhe rregullore të pa azhurnuara dhe të pa plota, nuk ka listë të proceseve dhe regjistër të rreziqeve.
- A11 Mungesa e dokumentimit të çertifikimit të pagesave nga zyrtari çertifikues në ndërmarrje.

Më gjerësisht shih në kapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KRM 'Pastërtia', .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i KRM 'Pastërtia', është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të KRM 'Pastërtia', në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRM 'Pastërtia', sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të KRM 'Pastërtia', .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e KRM 'Pastërtia', , për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet apo gjetje që kanë ndikuar opinionin e pasqyrave financiare janë, mos njohja e provizioneve për LLA, mos rivlerësimi i pasurive, prezantimi jo i saktë i rezervave tjera, mbivlerësimi i detyrimeve afatshkurta, nënvlerësimi i obligimeve tatimore, mungesa e dëshmimeve për pasuritë fikse si dhe shpалosja jo e saktë e fitimit të mbajtur në pasqyrat financiare.

Te konkluzioni i pajtueshmërisë kanë ndikuar gjetjet si, mungesa e kontratave për konsumatorë dhe llogaritë e arkëtueshme të pidentifikuara, mos harmonizimi i raportit të inventarizimit të pasurive dhe stoqeve me regjistrat kontabël, mangësi sa i përket pozitive të punës, mospagesa e kontributeve pensionale, funksionimi i dobët i kontrollit të brendshëm dhe çertifikimit të pagesave,

Ndërsa çështjet tjera të cilat nuk kanë ndikuar te opinion por vetëm te menaxhimi financiar dhe i pajtueshmërisë janë: mos harmonizimi i llogarive të pagushme dhe llogaritë e arkëtueshme, prokurimi i mallrave të përdoruara, mos emërimi i zyrtarit autorizues, mos përdorimi i sistemit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, mos plotësimi i kriterëve sipas dosjes së tenderit si dhe mos përgaditja e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga njësia e auditimit të brendshëm .

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Gjithashtu, ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 19 rekomandime, prej tyre 16 rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos provizionim i llogarive të arkëtueshme tregtare

Gjetja

SNRF 9 Instrumentet financiarë në paragrafin B5.5.35 sqaron se entiteti mund të llogaris humbje të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Entiteti do të përdorë përvojën e saj historike për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e aktivitetit financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, entiteti do të përdorë grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

Në pasqyrat financiare të vitit 2025, kompania kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,375,357€. Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018. Prandaj, mungesa e aplikimit të lejimeve/provizionimeve ndër vite ndikon që vlera bartëse neto e llogarive të arkëtueshme tregtare në PVF të mos jetë e saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti në gjashtë vitet e fundit nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të provizionimit të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos përfshirja e provizioneve për të arkëtueshmet në pasqyra financiare, ndikon në mbivlerësim të pasurive dhe rritë rrezikun për vendimmarrje të bazuar në të dhëna të pasakta.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe të bëhet provizionimi i llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e standardeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Përfshirje e transaksioneve jo relevante në zërin -Rezerat e tjera

Gjetja

SNK 16 përkatësisht pika 39 përcakton se: Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Po ashtu SNK 16 përcakton se: një aktive afatgjate njihet si aktive nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen rrjedhin të njësia ekonomike dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Në pasqyrat financiare, te zëri “Rezervat tjera” është paraqitur vlera prej 3,207,724€. Nga analiza e kartelës së këtij zëri rezulton se gjatë viteve janë regjistruar transaksione të ndryshme, përfshirë rregullime të obligimeve tatimore dhe interesave të aplikuara nga ATK për vonesat në pagesa, si dhe transaksione që lidhen me falje borxhesh, provizione dhe zëra të tjerë që nuk përkojnë me natyrën e rezervës. Këto transaksione janë përfshirë gabimisht në kategorinë e “Rezervave të tjera”, në vend që të paraqiteshin në linjat përkatëse në pasqyrat financiare.

Bazuar në konfirmimet zyrtare kjo gjendje ka ardhur si rezultat i regjistrimeve të pasakta ndër vite, ku në këtë zë janë bërë rregullime apo barazimet të ndryshme për obligimet tatimore, si dhe zëra të tjerë që nuk përkojnë me natyrën e këtij zëri.

Ndikimi Mungesa e dëshmive mbështetëse dhe regjistrimet e pasakta kontabël në sistem, në veçanti përfshirja e transaksioneve që nuk përkojnë me natyrën e rezervës (si obligime tatimore, interesa dhe falje borxhesh), pamundësojnë verifikimin e saktësisë së këtij zëri. Kjo mund të krijojë vështirësi për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm për të kuptuar qartë burimin dhe natyrën e këtyre ndryshimeve, duke rritur rrezikun e keq prezantimit të pozitës financiare të ndërmarrjes.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë korrigjimin e zërit rezervat e tjera sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes

Gjetja Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 16, pasuritë afatgjata materiale- rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftushme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Ndërmarrja që nga viti 2018 e këndeje nuk kishte bërë vlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi identifikuar se në regjistrin kontabël të pasurive janë të përfshira një numër i konsiderueshëm prej 99 pasuri me kosto historike në shumën prej 1,094,384€ dhe që janë të zhvlerësuara në tërësi, pra vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0). Edhe pse këto pasuri janë ende aktive, nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 7 vitesh.

Prandaj, përderisa këto pasuri ndërmarrja i përdor për përfitimet ekonomike konsiderojmë që vlera e drejtë e tyre e prezantuar në pasqyra nuk është e saktë.

Bazuar në konfirmimet e zyrtarëve, mungesa e rivlerësimit të pasurive kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja në vazhdimësi ishte ballafaquar me mungesën e mjeteve financiare, dhe nuk kishte mundësi të kryej procesin e rivlerësimit.

Ndikimi Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive të cilat ende janë në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre e prezantuar në pasqyra financiare, të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e drejtë.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin e pasurive nga një vlerësues i licencuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësimi i detyrimeve afatshkurta**Gjetja**

Sipas SNK 1- një njësi ekonomike duhet të përgatit pakon e plotë të pasqyrave financiare e cila ka për qëllim të përgjithshëm të sigurojë informacione lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare, fluksin monetar, si dhe shënimet shpjeguese të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare vjetore. Po ashtu sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 37, paragrafi 86, njësitë ekonomike duhet të shpalojnë në shënimet shpjeguese detyrimet kontingjente që mund të kenë ndikim të rëndësishëm financiar, nëse ato burojnë nga ngjarje të kaluara dhe ekziston mundësia që të rezultojnë në dalje të burimeve ekonomike në të ardhmen.

Ndërmarrja ka paraqitur në pasqyrat financiare për vitin 2025 detyrime afatshkurtra në vlerë prej 121,006€. Megjithatë, këto shuma lidhen me konteste gjyqësore ende të pazgjdhura dhe nuk përfaqësojnë detyrime të konfirmuara në bazë të një vendimi përfundimtar të gjykatës. Si rrjedhojë prezantimi i tyre si detyrime afatshkurtra ka rezultuar në mbi vlerësim të detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kjo kishte ndodh për shkak se departamenti i financave kishte konsideruar të mjaftueshme informacionet e prezantuara në shënimet shpjeguese.

Ndikimi

Shpaloja e pasaktë e detyrimeve kontingjente ka rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo tregon një pasqyrë të pasaktë të obligimeve reale të ndërmarrjes.

Rekomandimi A2

Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që detyrimet kontingjente të paraqiten saktë në pasqyrat financiare. Detyrimet që janë ende në proces gjyqësor nuk duhet të shfaqen si detyrime afatshkurtra, por të tregohen qartë në shënimet shpjeguese, duke dhënë informacion të plotë për natyrën dhe pasojat e mundshme financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Nënvlërësimi i obligimeve tatimore****Gjetja**

Sipas SNK 1, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje besushme të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në kornizën konceptuale për raportimin financiar.

Ndërmarrja në kuadër të pasqyrave financiare kishte prezantuar obligime tatimore në vlerë 672,374€, ndërsa bazuar në letër konfirmimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), gjendja e obligimeve të ndërmarrjes në fund të vitit 2025 ishte 780,839€. Si rezultat i kësaj obligimet e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar ishin nënvlerësuar për 108,465€.

Vlen të theksohet se ndërmarrja në prill të vitit 2025 kishte hyrë në marrëveshje me Administratën Tatimore për pagesën me këste të këtyre obligimeve tatimore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të obligimeve tatimore të ndërmarrjes me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK.

- Ndikimi** Diferenca lidhur me raportimin e obligimeve, ndikon që obligimet tatimore të keq deklarohen, dhe rrjedhimisht të ketë një prezantim jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiare.
- Rekomandimi C1** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kontrollet financiare të jenë më efektive dhe azhurnimi i të dhënave të bëhet me kohë në mënyrë që llogaritë tatimore dhe regjistrimet kontabël të reflektojnë prezantimin e drejtë të gjendjes në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesa e dëshmive mbështetëse për pasuritë fikse

- Gjetja** Bazuar në SNK 16 Pasuritë Afatgjata Materiale, kosto e një zëri të pasurive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihen si pasuri nëse: është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen asaj pasurie do të rrjedhin tek njësitë ekonomike dhe kosto e pasurisë mund të matet me besueshmëri.

Ndërmarrja për gjashtë (6) mostra në vlerë 89,169€[1], nuk ka arritur që të ofroj dëshmi përkatëse. Si rrjedhojë e kësaj nuk kemi qenë në gjendje t'i verifikojmë nëse gjendja e tyre është e saktë në pasqyrat financiare.

Mungesa e dëshmive ka ndodhur si rezultat i zhvendosjes së ndërmarrjes në objektin e ri, si dhe për shkak të mangësive në arkivimin e dokumentacionit nga departamenti i financave.

- Ndikimi** Mungesa e dokumenteve mbështetëse pamundëson vërtetimin dhe vlerësimin nëse zëri pasurisë e prekshme dhe të pa prekshme është prezantuar drejtë në pasqyrat financiare vjetore.
- Rekomandimi A3** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për të siguruar evidencat që dëshmojnë vlerën e plotë të pasurive të regjistruara në sistemin kontabël, të cilat rrjedhimisht prezantohen edhe në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos prezantim i saktë i pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese**Gjetja**

Sipas SNK 1- një njësi ekonomike duhet të përgatit pakon e plotë të pasqyrave financiare e cila ka për qëllim të përgjithshëm të sigurojë informacione lidhur me pozicionin financiar, performacën financiare, fluksin monetar, si dhe shënimet shpjeguese të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare vjetore.

Po ashtu sipas ligjit Nr. 06/L 016 për Shoqëritë Tregtare , neni 88, dhe Statutit të Ndërmarrjes neni 12, pika 2 citon se shpërndarja e dividendëve duhet të bëhet vetëm me autorizimin e aksionarit dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Gjatë kontrollimit dhe rillogaritjes së Pasqyrave Financiare, është konstatuar se në vitin 2024 është paraqitur shpërndarje e dividendës në vlerë totale prej 86,011€, përkatësisht: (44,665€ nga fitimet e mbajtura dhe 41,436€ nga rezervat).

Megjithatë, nga procedurat e auditimit është vërtetuar se nuk ekziston vendim për shpërndarjen e dividendës, pra nuk ka dokumentacion mbështetës për këtë transaksion, dhe se keto shuma janë përdorur si shifra balancuese për të arritur përputhje në pasqyrat financiare. Për më tepër, kjo pasaktësi është bartur në vitin 2025 në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Po ashtu ndërmarrja ka përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare, megjithatë, informacioni i paraqitur në këto shënime është i mangët dhe nuk përmban detaje të mjaftueshme për të gjithë zërat e pasqyrave financiare.

Mosprezantimi i saktë i pasqyrave financiare kishte ndodhur për shkak të përdorimit të shifrave balancuese pa dokumentacion mbështetës, mosrespektimit të kërkesave të standardeve përkatëse dhe mungesës së kujdesit profesional gjatë përgatitjes dhe verifikimit të tyre, ndërsa sa i përket shpalosjeve zyrtarët e ndërmarrjes i kishin konsideruar informacionet e dhëna në shënimet shpjeguese si të mjaftueshme.

Ndikimi

Gabimet materiale në zërat e veçantë kanë ndikuar në prezantim jo të saktë dhe të drejtë të pasqyrave financiare si dhe mosparaqitja e plotë e shënimeve shpjeguese, shkakton paqartësi në ofrimin e informatave, si ndikon që përdoruesit e pasqyrave financiare të mos kenë informacionet financiare të plota.,

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, pasqyrës së rrjedhës së parave, si dhe shënimeve shpjeguese dhe të marrë veprimet nevojshme korigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A5 - Mos lidhja e kontratave me konsumatorët dhe mungesa e emërimit të konsumatorëve

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, Nenit 4, paragrafit 1.35 Konsumator është personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas ligjit. Në këtë kuptim, ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave obligohen të lidhin kontrata me konsumatorët të cilëve u ofrojnë shërbime, me qëllim të rregullimit të të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella ndërmjet palëve.

Nga mostrat e testuara është konstatuar se ndërmarrja nuk ka arritur të lidhë kontrata me 25⁴ konsumatorët që përfitojnë shërbime të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave. Pavarësisht faktit se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve janë duke pranuar shërbime nga kompania, një pjesë e tyre vazhdojnë të mos kenë kontrata të formalizuara për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Po ashtu nga mostrat e testuara kemi konstatuar se në regjistrin e llogarive të arkëtushme të ndërmarrjes, ekzistojnë 14 konsumatorë, të cilët janë evidentuar pa emër, e që janë kreditor ndaj ndërmarrjes në shumën prej 4,164€.

Sipas zyrtarëve përgjegjës të kompanisë, kjo situatë është ndikuar kryesisht nga numri i madh i konsumatorëve, si dhe nga mungesa e gatishmërisë së disa konsumatorëve për të nënshkruar kontratat përkatëse të shërbimit, si dhe mos emërimi i konsumatorëve ka ndodhur për shkak të pamundësisë së identifikimit dhe kontaktimit të tyre edhe përkundër përpjekeve të ndërmarrjes.

Ndikimi

Mos lidhja e kontratave krijon pasiguri juridike dhe vështirëson ndërmarrjen e veprimeve administrative e ligjore ndaj konsumatorëve që nuk përmbushin obligimet financiare si dhe regjistrimi i konsumatorëve vetëm me shifra, pa emër ose informacione identifikuese, rrezikon mos arkëtimin e mjeteve për shkak të pamundësisë për të aplikuar masa ligjore.

Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë masa konkrete për të siguruar që të gjithë konsumatorët që përfitojnë shërbime të kenë kontrata të lidhura, si dhe të shqyrtojë brenda një afati të shkurtër masat për regjistrimin e konsumatorëve të evidentuar vetëm me shifra në emër të shfrytëzuesve të shërbimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurisë**Gjetja**

Sipas Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, shoqëritë tregtare janë të obliguara që të paktën një herë në vit të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit përmes procesit të inventarizimit. Rezultatet e inventarizimit duhet të jenë të harmonizuara me librat kontabël. Po ashtu sipas SNK 2 - Inventarët, kur ndërmarrja bënë daljen e materialit nga depo me qëllim të përdorimit ato duhet të njihen si shpenzim në periudhën të cilën ka ndodhur dalja.

Ndërmarrja në fund të vitit kishte themeluar një komision për inventarizimin e pasurive afatgjata dhe stoqeve, i cili kishte përgatitur raportin e inventarizimit. Nga krahasimi i raportit të inventarizimit të pasurive afatgjata dhe stoqeve me evidencat kontabël është konstatuar se ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistrit të aseteve dhe raportit të komisionit për inventarizim.

Po ashtu gjatë testimit të mostrave për blerjet e vitit 2025 u konstatua se blerjet e gomave në vlerë totale 30,890€, ishin njohur drejtpërdrejt si shpenzim dhe jo si stok. Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e shpenzimeve operative dhe nënvlerësimin e stokut në depo.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, mos harmonizimi ka ndodhur për shkak të aseteve të paregjistruara, mungesës së saldove fillestare dhe zhvendosjes në objekt të ri.

Ndikimi

Mangësitë në procesin e inventarizimit dhe mos harmonizimi me regjistrat kontabël shkaktojnë që gjendja reale fizike e pasurive të mos përputhet me gjendjen kontabël, duke rezultuar në një raportim jo të saktë mbi ekzistencën dhe vlerën e pasurive në pasqyrat financiare si dhe mosnjohja e gomave si pjesë e stokut në depo në momentin e blerjes rezulton në mbivlerësim të shpenzimeve operative dhe nënvlerësim të vlerës së stoqeve.

Rekomandimi A6

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive të kryhet në mënyrë të plotë dhe të rregullt, duke përfshirë harmonizimin e rezultateve të inventarizimit me regjistrat kontabël, si dhe të sigurojë që blerjet e tilla të njohën si stok në depo, në mënyrë që gjendja reale fizike e pasurive dhe stoqeve të reflektohet saktë në pasqyrat financiare para dorëzimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Emërimi i zyrtarëve të lartë pa procedure të hapur të rekrutimit dhe mosrespektimi i kriterit të përvojës menaxheriale**Gjetja**

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, respektivisht nenit 21 lidhur me nenin 17 të këtij ligji, si dhe parimeve të qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike, pozitat menaxheriale dhe pozitat kyçe në ndërmarrje duhet të plotësohen përmes procedurave të hapura dhe konkurruese për të siguruar transparencë, meritokraci dhe trajtim të barabartë të kandidatëve. Po ashtu sipas shpalljes së konkursit për rekrutimin e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv, kandidati duhet të posedojë të paktën 5 vite përvojë menaxheriale të dokumentuar.

Bordi i Drejtorëve kishte marrë vendim për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv dhe Sekretarit të ndërmarrjes edhe për një mandat pa zhvilluar procedurë të hapur të rekrutimit.

Po ashtu gjatë auditimit nga verifikimi i dokumentacionit të kandidatëve për konkursin Zëvendës Kryeshef u vërtetua se kandidati i emëruar nuk e përmbushte kriterin e kërkuar të përvojës menaxheriale prej 5 vitesh, siç ishte përcaktuar në shpalljen e konkursit.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i vendimit të Bordit të Drejtorëve, i cili e bazoi emërimin në performancën e mirë të kandidatëve në detyrat e mëparshme, ndërsa mungesa e një kontrolli të detajuar të dokumentacionit dhe vlerësimi i gabuar i përvojës si relevante rezultojnë në pranimin e një kandidati që nuk i plotësonte kushtet.

Ndikimi

Vazhdimi i mandatit pa kryer procedurë të hapur të rekrutimit, ndikon në dëmtimin e konkurrencës dhe mund të rezultojë me dështim në arritjen e objektivave të ndërmarrjes. Po ashtu përzgjedhja e një kandidati që nuk plotëson kriteret e shpallura mund të cenojë integritetin dhe transparencën e procesit të rekrutimit, të ulë besueshmërinë e procedurës dhe të ndikojë në cilësinë e vendimmarrjes së bordit.

Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që plotësimi i pozitave menaxheriale në ndërmarrje të bëhet përmes procedurave të hapura dhe konkurruese, me qëllim të angazhimit të kuadrove adekuata në bazë të meritës, si dhe të sigurojë verifikimin e plotë të dokumentacionit të kandidatëve në proceset e rekrutimit, në mënyrë që të përzgjidhen vetëm ata që plotësojnë kriteret e shpalljes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Plotësimi i pozitave pa respektimin e procedurave të parapara me kërkesat ligjore**Gjetja**

Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, përkatësisht neni 13 paragrafi 1, përcakton se çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë një zyrtar të prokurimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik.

Po ashtu, Ligji për Prokurimin Publik, neni 7 paragrafët 1 dhe 2, obligon autoritetet kontraktuese që të trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, jodiskriminuese dhe transparente, duke siguruar konkurrencë të hapur dhe të drejtë. Autoriteti kontraktues nuk duhet të zhvillojë asnjë aktivitet të prokurimit në mënyrë që kufizon apo eliminon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, apo që favorizon ose diskriminon një apo më shumë prej tyre.

Ndërkaq, sipas Ligjit Nr. 06/L-021, neni 21, njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga auditorë të brendshëm të punësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbyesit civil, Ligjin e Punës apo ligje të tjera përkatëse. Për më tepër, pika 2.2 thekson se auditorët e brendshëm duhet të posedojnë kualifikime dhe çertifikime profesionale adekuate, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Ndërmarrja kishte të emëruar një zyrtar të prokurimit, i cili më pas ka dhënë dorëheqje. Pas largimit të tij, ndërmarrja nuk ka zhvilluar procedura të rregullt të rekrutimit për plotësimin e kësaj pozite. Përkundrazi, është lidhur drejtpërdrejt një kontratë për shërbime, pa ndjekur procedurat e përcaktuara të prokurimit publik, me arsyetimin se mungonte personi përgjegjës për zhvillimin e këtyre procedurave.

Gjithashtu, është konstatuar se zyrtarja e auditimit të brendshëm është emëruar në pozitën e auditores së brendshme me vendim të menaxhmentit, si dhe nuk posedon çertifikim profesional si auditore e brendshme.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosrespektimit të kërkesave ligjore dhe procedurave të rekrutimit, si dhe mungesës së kontrolleve të brendshme efektive në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Ndikimi

Moszbatimi i procedurave të prokurimit dhe shmangia e procedurave të rregullta të rekrutimit rrit rrezikun për mungesë transparence dhe konkurrencë, si dhe mund të rezultojë në përzgjedhje jo meritore dhe detyrat të mos kryhet sipas standardeve profesionale.

Rekomandimi A8

Bordi i drejtoreshave duhet të sigurojë që plotësimi i pozitave të rregullta të bëhet përmes procedurave të rregullta të rekrutimit dhe që çdo angazhim përmes kontratave për shërbime të realizohet përmes procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet transparencë, konkurrencë dhe respektim i plotë i kërkesave ligjore. Gjithashtu, duhet të sigurohet që personi i caktuar në pozitë të posedojë çertifikimet dhe kualifikimet e nevojshme profesionale për ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Mos pagesa e kontributeve pensionale dhe tatimit në të ardhurat personale

Gjetja

Sipas Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale, kërkohet që secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara të punëtorëve të tij, dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK-ja brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të lëshuar nga Ministri.

Po ashtu, Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, kërkohet që punëdhënësi të zbret kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe të bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Ndërmarrja në pasqyrat financiare kishte prezantuar obligime ndaj kontributeve pensionale në vlerë prej 228,649€ dhe obligime ndaj tatimit në paga në vlerë prej 132,030€. Obligimet e tilla ndërmarrja nuk i kishte paguar sipas afateve ligjore.

Vlen të theksohet se ndërmarrja në prill të vitit 2025 kishte hyrë në marrëveshje me Administratën Tatimore për pagesën me këste të këtyre obligimeve tatimore.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, mos pagesa e këtyre detyrimeve është si rezultat i gjendjes së vështirë financiare të ndërmarrjes.

Ndikimi

Mos pagesa e detyrimeve tatimore ndaj pagave dhe kontributeve pensionale, ndikon që të aplikohen ndëshkime nga autoritetet tatimore për mos pagesë të obligimeve në afatin kohor. Kjo ka ndikim edhe në depozitat kursimore në Trustin Pensional të Kosovës, dhe rrjedhimisht edhe në pagesën e pensioneve më të vogla për punëtorët kur pensionohen, çka përbën shkelje ligjore të të drejtave të punëtorëve.

Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se të gjitha obligimet e kontributeve pensionale dhe tatimet të buxhetohen dhe të paguhen sa më parë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm**Gjetja**

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nenit 30 pika 30.1 deri më 31 tetor të çdo viti kalendarik, zyrtarët e çdo ndërmarrjeje publike duhet të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm, në pajtueshmëri me politikën zhvillimore të sektorit dhe Planet zhvillimore komunale. Plani duhet të dorëzohet së pari për miratim nga Bordi i Drejtorëve, dhe pas miratimit t'i dorëzohet për informacion Ministrit ose Komisionit/Komisioneve përkatëse Komunale të Aksionarëve. Plani i Biznesit mund të rishikohet pas gjashtëmuajorit të parë të vitit.

Po ashtu sipas Ligjit nr. 06/L-021 neni 4, pikat 1.1 deri 1.9 theksojnë se Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik, në këtë rast Bordi, ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit dhe për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe proceseve që ndërlidhen me zbatimin e tyre.

Kompania nuk ka të vendosur në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Kompania nuk kishte miratuar draftin e planit të biznesit për vitin 2025-2027;
- Kompania ka rregulla të formalizuara për menaxhimin e pasurisë por që rregullorja aktuale është më shumë e natyrës së organizatave buxhetore dhe nuk adreson procedurat specifike të kompanisë;
- Rregullorja e shpenzimeve operative nuk është ndryshuar që nga viti 2012, edhe pse ka pasur plotësime dhe ndryshime në legjislacion;
- Nuk ka politika për provizionimin e llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme, si dhe për menaxhimin e të hyrave.
- Kodi i Etikës nuk është azhurnuar që nga viti 2009;
- Kompania nuk disponon një regjistër të rreziqeve dhe nuk ka politika të formalizuara për menaxhimin e rrezikut.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos vendosjes së një mjedisi të kontrollit i cili do të mundësonte strukturat e duhura organizative, linja të qarta të raportimit, autoritetin e nevojshëm dhe përgjegjësitë për arritjen e objektivave.

Ndikimi

Mos vendosja e një sistemi të kontrollit të brendshëm të plotë ndikon në performancën e kompanisë përball përcaktimit të objektivave të saj. Po ashtu mangësitë e tjera të përshkruara më lart mund të ndikojnë që kompania të mos arrij të përmbush obligimet operative dhe financiare të saj.

Rekomandimi A10

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që plani i biznesit të miratohet me kohe si dhe që të hartohen të azhurnohen politikën, procedurat dhe rregulloret për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, të përgatitet lista e proceseve dhe regjistri i rreziqeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mungesa e dokumentimit të çertifikimit të pagesave nga zyrtari çertifikues

Gjetja

Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, neni 14 paragrafi 1 përcakton se çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë një zyrtar çertifikues si dhe paragrafi 14.3 përcakton që zyrtari çertifikues është përgjegjës që të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës.

Ndërmarrja kishte të përcaktuar në organogram pozitën e zyrtarit çertifikues si pjesë e strukturës së saj organizative, mirëpo gjatë auditimit është konstatuar se, megjithëse kjo pozitë ekziston formalisht, në praktikë nuk ka pasur dëshmi që zyrtari çertifikues ka ushtruar funksionin e tij ligjor dhe profesional, pasi pagesat janë realizuar pa u dokumentuar se janë çertifikuar apo aprovuar nga ky zyrtar.

Kjo ka ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti dhe mungesës së një kontrolli të qartë për realizimin dhe dokumentimin e aprovimit të pagesave nga zyrtari çertifikues.

Ndikimi

Mbikëqyrja e pamjaftueshme nga menaxhmenti dhe mungesa e një kontrolli të qartë për aprovimin e pagesave nga zyrtari çertifikues ka sjellë mungesë gjurmueshmërie dhe transparence në procesin e pagesave. Kjo rrit rrezikun për pagesa pa kontroll adekuat, pagesa të paautorizuara dhe përgjegjësi të paqarta në menaxhimin financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi A11

Bordi mbikëqyrës duhet të sigurojë që janë zhvilluar dhe zbatohen procedura të qarta dhe të dokumentuara për të siguruar kontroll të duhur dhe transparencë në proceset e brendshme financiare, duke përfshirë dokumentimin e çertifikimit të pagesave nga zyrtari çertifikues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Detyrimet afatshkurta

Vlera neto e zërit financiar të detyrimeve afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 121,679€. Brenda këtij zëri janë prezantuar detyrimet kontigjente në vlerë 121,006 dhe detyrimet ndaj pagave 673 €.

Çështja A12 - Mos harmonizimi i gjendjes kontabël dhe llogarive të furnitorëve

Gjetja Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, në neni 12, pika 1 dhe 2, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre zërave dhe dëshmime të tyre mbështetëse.

Gjatë testimit të llogarive të pagueshme, përveç procedurave të tjera, janë dërguar 6 letra konfirmimi tek furnitorët, me një vlerë totale prej 725,365€. Nga përgjigjet e pranuar, dy furnitorë kanë konfirmuar se detyrimet e ndërmarrjes ndaj tyre janë për 5,873€ më të larta krahasuar me regjistrat kontabël të ndërmarrjes, ndërsa një furnitor ka konfirmuar një shumë prej 1,331€ më të ulët se ajo e regjistruar në kontabilitet.

Si rezultat, është konstatuar se obligimet e paraqitura nga ndërmarrja nuk përputhen me konfirmimet e furnitorëve, duke rezultuar në një diferencë neto prej 4,542€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos aplikimit të harmonizimeve në baza periodike dhe komunikimit jo të mjaftueshëm të kompanisë me furnitorët.

Ndikimi Mos harmonizimi vjetor i të dhënave të ndërmarrjes dhe kartelave të furnitorëve të saj, mund të ndikojë në prezantimin e mbivlerësuar/nënvlerësuar të llogarive të pagueshme në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A12 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes kompanisë, dhe furnitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve dhe vizitave te furnitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të detyrimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në shumën 981,052€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të derivateve, mirëmbajtjes, deponive, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e mjeteve motorike dhe të tjera.

Çështja A13 - Prokurimi i mallrave të përdorura dhe mos plotësimi i kriterëve sipas dosjes së tenderit

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë që përcakton prokurimin e mallrave të përdorura. Megjithatë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në sqarimet e dhëna tek pyetjet e shpeshta, përgjigjeje këto të prezantuara në web-faqen e saj në lidhje me këtë temë, sqaron se pavarësisht që ligji i prokurimit nuk e ndalon prokurimin e mallrave të përdorura një gjë e tillë nuk rekomandohet. Arsyetimi për këtë është se specifikimet teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktues (AK) nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifika teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet e performancës dhe funksionalitetit. Për më tepër, prokurimi i mallrave të përdorura mbetet nën përgjegjësin e Autoritetit Kontraktues (AK). Ndërsa, neni 6 i LPP përcakton se të gjitha AK, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Po ashtu LPP, neni 27, citon se autoriteti kontraktues duhet të përpilojë dosjen e tenderit duke përfshirë të gjitha kriteret e përshtatshmërisë dhe përzgjedhjes, të cilat duhet të respektohen gjatë vlerësimit të ofertave.

Ndërrmarrja kishte zhvilluar procedurën e prokurimit për furnizimin me dy automjete (pickup) të përdorura dhe një kamionetë të përdorur për nevojat e saj operative, ku në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ishin përcaktuar edhe kushtet teknike, përfshirë vitin e prodhimit (jo më i vjetër se 2004 për pickup dhe jo më i vjetër se 2001 për kamionetë), si dhe kërkesat për furnizime të ngjashme.

Po ashtu gjatë auditimit të procedurës për furnizim me dy automjete (pickup) të përdorura është vërejtur se operatori ekonomik i përzgjedhur nuk ka arritur të dëshmojë plotësisht përvojën e kërkuar, pasi ka paraqitur vetëm një kontratë të ngjashme që nuk e plotëson vlerën minimale prej 12,000€, ndërsa kontratat tjera të dorëzuara nuk janë të natyrës së njëjtë me furnizimin e kërkuar. Si rrjedhojë, nuk janë përmbushur në tërësi kriteret e përcaktuara për kualifikim në dosjen e tenderit.

Sipas arsyetimeve të dhëna nga zyrtarët e prokurimit, këto procedura të blerjeve të kamionëve të përdorur, ishin realizuar në mungesë të mjeteve financiare ndërsa sa i përket mos përmbushjes së kriterit, komisioni i vlerësimit nuk ka kryer shqyrtim dhe verifikim të mjaftueshëm të ofertave, çka ka rezultuar në vlerësim jo të duhur dhe ka mundësuar përzgjedhjen e një operatori ekonomik që nuk i plotësonte kriteret e kërkuara.

Ndikimi Prokurimi i mallrave të përdorura mund të ndikojë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave të blera. Blerja e produkteve të përdorura vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar për parinë e dhënë duke ndikuar që ndërmarrja të paguajë çmime jo konkurruese për produkte të tilla, si dhe përzgjedhja e një operatori që nuk i plotëson kriteret e përcaktuara rrit rrezikun për realizim jo cilësor të kontratës dhe cenon parimet e transparencës, konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë në prokurim publik.

Rekomandimi A13 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Përveç kësaj, kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo-diskriminues, si dhe të sigurohet që gjatë vlerësimit të ofertave të bëhet verifikim i plotë dhe i saktë i përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, dhe të refuzohen ofertat që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A14 - Mos emërimi i zyrtarit autorizues për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit

Gjetja Ligji i prokurimit publik, nenet 22.1. dhe 22.2. specifikojnë se për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, zyrtari kryesor administrativ duhet të caktojë një person që të shërbejë si zyrtar autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit.

Ndërmarrja nuk kishte emëruar zyrtar autorizues për iniciim të aktiviteteve të prokurimit. Këtë rol e ushtronte Kryeshefi Ekzekutiv, i cili autorizonte iniciimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit.

Mos emërimi i zyrtarit autorizues ka ndodhur për shkak të dështimit të menaxhmentit për të vendosur kontrollet dhe pozitat e duhura në ndërmarrje, sipas kërkesave të dispozitave ligjore.

Ndikimi Mungesa e zyrtarit autorizues paraqet mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm gjatë ciklit të inicimit të aktiviteteve të prokurimit.

Rekomandimi A14 Bordi i drejtoreve të sigurojë se ekziston ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe të ndërmarrë veprime adekuate për emërimin e zyrtarit autorizues, për të mundësuar forcimin e kontrolleve të brendshme dhe respektim të dispozitave ligjore të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A15 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave

Gjetja Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, përmes të modulit për vlerësim nga menaxherët e kontratës, gjatë dhe pas përfundimit të implementimit të kontratave publike. Po ashtu, neni 70.24.f. përcakton se menaxheri i kontratës është përgjegjës për përgatitjen, mbajtjen dhe arkivimin e të gjithë regjistrave të menaxhimit të kontratës në këtë modul.

Në pesë (5) raste është konstatuar se menaxherët e kontratave nuk kanë përdorur modulën për menaxhimin dhe vlerësim të performancës në sistemin e prokurimit elektronik, siç kërkohet me rregullore.

Kjo situatë ka rezultuar si pasojë e mungesës së njohurive të nevojshme të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit të dedikuar si dhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe mbështetjes së duhur nga ana e zyrës së prokurimit.

Ndikimi Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të marrë informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

Rekomandimi A15 Bordi i drejtoreshave duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistemin e prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë. Po ashtu, ndihmon për përmbushjen e objektivave, duke nxitur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e rrezikut, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga dy auditorë të brendshëm.

Çështja A16 - Mospërgatitja e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve

Gjetja Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB) 2500.A1 parashohin që Drejtori i NJAB duhet të themelojë procese përcjellëse për monitorim dhe të sigurohet se veprimet e stafit të lartë menaxhues janë zbatuar në mënyrë efektive apo që stafi i lartë menaxhues ka pranuar rrezikun për mos marrje të veprimeve.

NJAB kishte planifikuar në planin vjetor të auditimit realizimin e pesë (5) auditimeve, por ishin realizuar katër (4) auditime, megjithatë, për raportet e këtyre auditimeve, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara, NJAB duhet të përgadis formatin planit të veprimit, duke përfshirë të gjitha rekomandimet e dala nga auditimet. Ky plan duhet të përcaktojë qartë veprimet konkrete, njësitë/drejtoritë përgjegjëse për zbatimin, si dhe afatet kohore përkatëse. Në rastin konkret, ky proces nuk është zbatuar. pasi që plani i veprimit nuk është përgatitur.

Këto mangësi janë rezultat i mungesës së përkushtimit të menaxhmentit dhe drejtorive përgjegjëse për përgatitjen e planit të veprimit për rekomandimet e dhëna.

Ndikimi Mos përgatitja e formalizuar e planit për zbatimin e rekomandimeve dhe mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve rrezikon mos informimin me kohë të bordit drejtues dhe vonesa në zbatimin e rekomandimeve, të cilat si rrjedhojë pamundësojnë përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit me kohë.

Rekomandimi A16 Bordi i drejtoreve të sigurojë që të gjitha drejtoritë e audituara të përgadisnin planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me udhëzimet përkatëse ndërsa NJAB duhet të zhvillojë procedurë të qartë dhe të dokumentuar për ndjekjen dhe raportimin e progresit të rekomandimeve të dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Auditimi për Pasqyrave Financiare të ndërmarrjes publike “Pastërtia” sh. a. ishte kryer nga një kompani e kontraktuar e auditimit dhe ka rezultuar me 3 rekomandime. Ndërmarrja nuk kishte përgatitur një plan veprimi për të paraqitur mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, vetëm një (1) nga këto rekomandime ishte zbatuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 1.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe të bëhet provizionimi i llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e standardeve.	Ndërmarrja nuk kishte marrë veprimet konkrete për këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrimit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin e pasurive nga një vlerësues i licencuar.	Ndërmarrja nuk kishte marrë veprimet konkrete për këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kontrollet financiare të jenë më efektive dhe azhurnimi i të dhënave të bëhet me kohë në mënyrë që llogaritë tatimore dhe regjistrimet kontabël të reflektojnë prezantimin e drejtë të gjendjes në pasqyra financiare.	Ndërmarrja kishte nënshkru marrëveshje me ATK për pagesën e obligimeve tatimore mirëpo ende borxhet janë të larta.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Arnisa Aliu, Udhëheqëse e ekipit



Fanol Hodolli, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRM 'Pastërtia' Sh.A., për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Basri Sula

(Kryeshef Ekzekutiv),

Data 28.Prill.2026, Ferizaj.



KOMPANIA REJONALE E MBETURINAVE
"PASTËRTIA" SH.A.
Nr. 1051
FERIZAJ 02.04.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Kompania Rejonale e Mbeturinave/ Regional waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada
KRM "PASTËRTIA" SH.A FERIZAJ
Rr. "Magjistralja Ferizaj-Kaçanik / Kilometri gjashtë (6) nga Ferizaj" Nr. 47 Tel. 0290/325-025



Bordi i Drejtorëve KRM "Pastërtia Sh.a.Ferizaj, bazuar Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.02/L-123, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111, në Statutin e Kompanisë në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2026 morri:

V E N D I M

TË APROVOJ PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2025, TË CILAT PASQYRA JANË ÇERTIFIKUAR NGA KONTABILISTI I JASHTËM I ÇERTIFIKUAR, TË BAZUARA NË AKTIVITETIN FINANCIAR TË KOMPANISË PËRGJATË VITIT 2025

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastërtia"sh.a. Ferizaj në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 si pikë të veçantë të rendit të ditës e ka përcaktuar shqyrtimin e Pasqyrave Financiare për Vitin 2025.

Pasqyrat Financiare 2025 të paraqitura në mbledhjen e Bordit e Drejtorëve, paraprakisht janë çertifikuar nga Kontabilisti i Jashtëm i Çertifikuar, ashtu siç është e paraparë me ligj, dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve pas shqyrtimit dhe analizimit me votat **PËR** të të gjithë anëtarëve aprovuan Pasqyrat Financiare për vitin 2025, respektivisht Bordi i Drejtorëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

KUSHTRIME IDRIZI

KOMPANIA REJIONALE E MBETURINAVE
"PASTËRTIA" SH.A.
Nr. 899
FERIZAJ 17.03.2026

„Kompania Regjionale e Mbeturineve Pastërtia SH.A.”

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundon më 31.12.2025

Mars 2026

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale e Mbeturinave Pastërta SH.A.

Përmbajtja

- Deklarata e pajtueshmërisë
- Raporti i përpilimit i praktikuesit (kontabilistit të çertifikuar)
- Pasqyra e pozitës financiare
- Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- Pasqyra e ndryshimit në ekuitet
- Pasqyra e rrjedhës së parasë
- Shpalosja me shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale e Mbeturinave Pastërtia SH.A.

Deklarata e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2025

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtet të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë, dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Drejtori i përgjithshëm /ekzekutiv

Basri Sula



Zyrtari Kryesor/Përgjegjës i Financave

Mustaf Zeqa

Ferizaj, Mars 2026

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale e Mbeturinave Pastërtia SH.A.

Raport i Kontabilistit për Përpilimin e Pasqyrave Financiare

Për: Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

NUI: 811320994

FUSHËVEPRIMI

Në bazë të informacionit të dhënë dhe në përputhje me angazhimin e shërbimit të rënë dakord, ne kemi ndihmuar në përpilimin e pasqyrave financiare për KRM PASTËRTIA SH.A. për vitin e mbyllur që përfundon më 31 dhjetor 2025. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshkruara në shënimet e këtyre pasqyrave financiare.

PËRGJEGJËSITE

Menaxhmenti i kompanisë është plotësisht përgjegjës për informacionin që përmbajnë pasqyrat financiare të përcaktuara nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM) të kërkuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Ne jemi angazhuar për të plotësuar kërkesat ligjore si dhe për të përmbushur nevojat për qëllimin që janë përgatitur këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur ekskluzivisht për përfitim tuaj. Ne nuk pranojmë përgjegjësi ndaj asnjë personi tjetër për përmbajtjen e pasqyrave financiare.

NUK JANE KRYER PROCEDURA AUDITIMI/ RISHIKIMI

Procedurat tona përdorin ekspertizën e kontabilitetit për të bërë përpilimin e pasqyrave financiare nga informacionet që na janë ofruar. Procedurat tona nuk përfshijnë procedurat e verifikimit ose vlefshmërisë. Asnjë angazhim auditimi ose rishikimi nuk është kryer dhe në përputhje me rrethanat, nuk është shprehur asnjë opinion e siguri.

PAVARËSIA

Ne nuk kemi asnjë përfshirje tjetër në kompaninë KRM PASTËRTIA, përveç përgatitjes së pasqyrave financiare duke u bazuar në informacionin financiar të cilin menaxhmenti i kompanisë na e ka ofruar.

HEQJA E PËRGJEGJËSISË

Ne kemi përpiluar këto pasqyra financiare bazuar në informacionin e dhënë nga menaxhmenti si përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informatave të përdorura në përpilim, dhe meqenëse përpilimi nuk është angazhim sigurie dhe nuk ka qenë subjekt i një angazhimi të auditimit ose rishikimit, ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi për besueshmërinë, saktësinë apo terësinë e informacionit financiar të përpiluar të përfshirë në pasqyrat financiare, nuk pranojmë asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji, përfshirë përgjegjësinë për shkak të pakujdesisë, ndaj cilit do person për humbjet e bëra si rezultat i besimit në këto pasqyra financiare.

Ekrem Beqa
Kontabilist i Çertifikuar

KONTABILIST I ÇERTIFIKUAR
Ekrem BEQA



Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

Pasqyra e Pozitës Financiare
Më 31 dhjetor 2025

	31 dhjetor 2025 (në EUR)	31 dhjetor 2024 (në EUR)
PASURITË		
Pasuritë afatshkurtëra		
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,835	5,392
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	4,375,357	3,634,669
Stoku	2,143	2,357
Pasuritë tjera afatshkurtëra	1,883	750
Gjithësej pasuritë afatshkurtëra	4,382,218	3,643,168
Pasuritë afatgjata		
Pasuritë e paprekshme	-	-
Prona dhe pajisje	1,544,630	1,665,892
Pasuritë tjera afatgjata	-	-
Gjithësej pasuritë	1,544,630	1,665,892
GJITHËSEJ PASURITË	5,926,848	5,309,060
DETYRIMET		
Detyrimet Afatshkurtëra		
Mbitërheqja bankare	95,260	92,302
Detyrimet ndaj tatimeve te pagueshme	672,374	711,188
Llogaritë e pagueshme tregtare	775,918	646,781
Detyrimet tjera afatshkurtëra	121,679	1,188
Gjithësej detyrimet afatshkurtëra	1,665,231	1,451,459
Detyrimet Afatgjata		
Kreditë dhe huatë , pjesa afatgjate	-	-
Detyrimet ndaj lizingut , pjesa afatgjate	-	-
Detyrime tjera afatgjate	-	-
Gjithësej detyrimet afatgjata	-	-
GJITHSEJ DETYRIMET	1,665,231	1,451,459
EKUITETI		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat e tjera	3,207,724	3,207,724
Fitimi/(Humbja) e mbajtur	1,028,893	624,877
Gjithësej ekuiteti	4,261,617	3,857,601
Gjithësej detyrimet dhe ekuiteti	5,926,848	5,309,060

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Basri Sula



Kryetari Kryesor/Përgjegjës i Financave

Mustaf Zeqa

Kontabilisti i Certifikuar

KONTABILIST I CERTIFIKUAR

Ekrem Beqa

Shënimet shpjeguese në faqet 1-18 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 (në EUR)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 (në EUR)
Të Hyrat nga Shitja	3,435,043	3,057,188
Kosto e Mallit të Shitur	-	-
Fitimi Bruto	3,435,043	3,057,188
Të ardhurat tjera	-	-
Shpenzimet e personelit	(1,973,565)	(1,797,174)
Shpenzimet zhvlerësimit	(20,313)	(34,847)
Shpenzime të tjera operative	(981,052)	(807,230)
Fitimi/humbja operative	460,113	417,938
Të ardhura financiare	-	-
Shpenzime financiare	(11,206)	(6,513)
Fitimi/humbja para tatimit	448,906	411,425
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(44,891)	(41,142)
Fitimi/(humbja) neto e vitit	404,016	370,282
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali I Fitimit/(Humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin	404,016	370,282

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbrojturave Pastërtia SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në ekulitet
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025

	Kapitali Aksionar (në EUR)	Fitimet/(Humbjet) e Mbajtura (në EUR)	Rezervat e tjera (në EUR)	Gjithësej (në EUR)
Pozicioni financiar më 1 janar 2024	25,000	299,260	3,249,070	3,573,330
Fitim/Humbja i/e vitit	-	370,282	-	370,282
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Tërheqjet	-	(44,665)	(41,346)	(86,011)
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	25,000	624,877	3,207,724	3,857,602
Fitim/Humbja i/e vitit	-	404,016	-	404,016
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Tërheqjet	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2025	25,000	1,028,893	3,207,724	4,261,617

Shënimet shpjeguese në faqet 7 -18 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi/Humbja para tatimit	448,906	411,425
Rregullime për zërat jo-monetare:		
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	20,313	34,847
Amortizimi i pasurive të paprekshme	-	-
Fitim/Humbja nga shitja e pronave dhe pajisjeve	36,332	-
Shpenzimet e financiare	11,206	6,513
Të ardhura nga interesi	-	-
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	516,758	452,785
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	(740,688)	(566,923)
Stoku	214	3,784
Pasuritë tjera afatshkurtëra	(1,133)	(400)
Llogaritë e pagueshme tregtare	129,137	109,809
Detyrimet tjera afatshkurtëra	120,491	122,895
Interesi i paguar	(11,206)	(6,513)
Tatimi në fitim i paguar	-	(41,142)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative	(503,185)	(378,490)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Investimet në pasuritë financiare të vlefshme për shitje	-	-
Arkëtimet nga shitja e investimeve të mbajtura deri në maturitet	-	-
Pagesat për blerjet e pronës dhe pajisjeve	(19,087)	(21,202)
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet nga shitja e pronës , pajisjeve dhe impianteve	-	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese	(19,087)	(21,202)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet/Tërheqjet në kapitalin shtese	-	(85,639)
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat tjera financiare	-	-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	(85,639)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të saj	(5,514)	(32,547)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	(86,910)	37,939
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	(92,424)	5,392

Shënimet shpjeguese në faqet 7 -18 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

1. INFORMATAT E PËRGJITHSHME

Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A. është e regjistruar në qendrën e regjistrimit të bizneseve(MTI) në Prishtinë, me datën 28/12/2007, me adresë Ferizaj, Rruga Enver Topalli, nr.42. Biznesi është pajisur edhe me Numër Unik Identifikues 811320994.

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes
Bazri	Sula	Kryeshef ekzekutiv

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Komuna e Shitimes	2,425.00 €	9.70 %
Komuna Ferizaj	19,750.00 €	76.70 %
Komuna Kaçanik	3,400.00 €	13.60 %

Bordi

Emri	Mbiemri	Pozita
Selaçin	Goga	Ankar i Bordit
Kuçtrimë	Idrizi	
Ferd	Bilali	Ankar i Bordit
Lirije	Luta	

Njësitë

Numri i Njësisë	Emri i Njësisë	Kodi	Vendi
503223	Njësia Operative Pastërtia	3811	Ferizaj
512595	Njësia Operative Pastërtia	3811	Kaçanik
5217199	Njësia Operative Pastërtia	3811	Shitme

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
3811	Grupullimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Aktiviteti kryesor i biznesit
8129	Aktivitetet e tjera të përbashkëta	Aktiviteti sekondar
8299	Aktivitetet e tjera shpërndarë në mbështetje të bizneseve p.k.t.	Aktivitetet tjera
9609	Aktivitetet e tjera p.k.t.	Aktivitetet tjera
3821	Trajtimi dhe asgjëtimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Aktivitetet tjera
3832	Rikuperimi i materialëve të klasifikuar	Aktivitetet tjera
4477	Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe bekurishëve	Aktivitetet tjera

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

2. PASQYRA E POLITIKAVE TË RENDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3. Valuta e paraqitur

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro(EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës(BQK), Euro është valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej dates 1 janar 2002.

2.4. Valuta e këmbimit

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit egzistues në datën e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat e huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga rimatjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fundvitit paraqiten si fitim ose humbje. Zërat jomonetar të matur me kosto historike janë të shkëmbyera duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit(jo të rishkëmbyera). Zëra jomonetar të matur me vlerën e drejtë janë shkëmbyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

2.5. Stoqet

Stoqet janë vlerësuar në kosto më të ulët dhe vlerë neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit minus kosto e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kostot e furnizimit dhe pjesëve rezervë janë vendosur duke përdorur metodën e ponderuar mesatare dhe përfshinë shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin egzistues dhe gjendjen egzistuese të tyre.

2.6. Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesat	5%	20 vite
Makineritë e renda	10%	10 vite
Impiantet	20%	5 vite
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20%	5 vite

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

2 .PASQYRA E POLITIKAVE TË RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.7. Prona, impiantet dhe paisjet(vazhdim)

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohen dhe korrigjohen nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme. Fitimet ose Humbjet nga shitja e aseteve përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur dhe paraqiten në pasqyrën e të ardhurave.

2.8. Tatimi në të ardhura aktuale dhe të shtyera

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe të tatimin e shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit. Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të aseteve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditim tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë që, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar, ka më shumë gjasa që të rimerret sesa që të mos rimerret. Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të zbatohet në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhave në të cilat tatimi i shtyrë si aset pritet që të realizohet ose detyrimet e shtyra tatimore që të zgjidhen, në bazë të normave tatimore që janë në fuqi ose që do të jenë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

2.9. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura në banka dhe investimet afatshkurtera me likuiditet të lartë që skadojnë brenda një periudhe deri 12 muaj.

2.10. Ekuiteti, rezervat, fitimet e mbajtura

Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2025 kapitali aksionar është në vlerë prej 25,000.00 Euro
(31 dhjetor 2024; 25,000.00 Euro)

Fitimet e mbajtura

Fitimet e mbajtura përbëhen nga fitimet e periudhave të kaluara dhe aktuale.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

2.-PASQYRA E POLITIKAVE TË RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

2.11. Përfitimet e punëtorëve

Detyrimet pensionale

Kompania ka skemë të pensioneve të përcaktuara nga legjislacioni vendor i sigurimeve shoqërore, sipas të cilës ajo kontribuon në planin e pas daljes në pension të punëtorëve të saj. Kontributet, bazuar në pagat bruto janë bërë në planin e pensionit shtetëror, Trusti pensional i Kosovës (TPK) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Nuk ka asnjë detyrim shtesë në lidhje me këto plane.

2.12. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera njihen në vlerën reale dhe më pastaj maten me kostot e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

2.13. Të hyrat

Të hyrat përbëhen nga të hyrat nga shitja e mallrave. Të hyrat janë matur duke iu referuar vlerës së drejtë të konsideratës së pranuar apo të arkëtueshme nga kompania për mallrat e furnizuar dhe shërbimet e ofruara, përjashtuar TVSH-në, rabatet dhe zbritjeve tregtare. Të hyrat njihen kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, ka gjasa që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksione do të rrjedhin në kompani, shpenzimet e bëra ose që do të bëhen mund të maten me besueshmëri, dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbyshur.

Shitja e mallrave

Shitja e mallrave njihet kur kompania ka transferuar tek blerësi rreziqet dhe përfitimet e rendesishme të pronësisë së mallrave të furnizuara. Rreziqet dhe përfitimet janë konsideruar të bartën te blerësi kur konsumatori ka marrë ofrimin e mallrave.

2.14. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

2.15. Shpenzimet e huazimit

Shpenzimet e huazimit kryesisht përbëhen nga interesi mbi huazimet e kompanisë. Të gjitha kostot e huamarrjes, duke përfshirë koston e huamarrjes drejtpërdrejte i atribuohet përvetësimit, ndërtimit apo prodhimit të një asemi të caktuar, janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar dhe raportuar në shpenzime financiare tek pasqyra e të ardhurave.

2.16. Tatimet

Kompanisë i është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkular në përputhshmëri me rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale. Obligimet e kompanisë për tatimin në fitim të vitit kalkulohe në bazë të shkallës së tatimit 10%. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mund të barten për tu vendosur në gjashtë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërta S.H.A.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

3.1. Faktorët e riskut financiar

Aktivitet e kompanisë e bënë atë të një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqendrohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizoj efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë. Menaxhimi i riskut kryhet nga menaxhmenti i kompanisë të bazuar në disa politika dhe procedura paraprakisht të aprovuara me shkrim që mbulon plotësisht menaxhimin e riskut, si dhe zona të veçanta, të tilla si risku i këmbimit valutor, riskut të normës së interesit, risku i kredisë, përdorimit të letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimit përtej likuiditetit.

3.2. Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat kompanisë ose vlerën e titujve të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm derisa optimizon kthimin.

3.3. Risku i monedhës

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që operon vetem në valutën Euro (EUR).

3.4. Risku i kredisë

Risku i kredisë është risk në humbjen financiare të kompanisë, nëse një klient ose homolog i një instrumenti financiar nuk arrin të përbushë detyrimet e tij të kontraktuara, dhe lindin kryesisht nga të arketueshmet e kompanisë prej klientëve investimeve në letra me vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Ky ekspozim mund të varet nga risku i mos pagesës në industri dhe tregun e brendshëm në të cilën vepron Kompania. Kompania krijon një lejim për dëmtimet që pasqyrojnë vlerësimet e saj të humbjeve të shkaktuara në lidhje me të arkëtueshmet tregtare, të arkëtueshmet tjera dhe investimet. Komponentët kryesorë të këtyre lejimeve janë komponentë të veçantë të humbjes që ka të bëjë me ekspozimet individuale të rëndësishme, dhe një komponentë e përbashkët e humbjes e themeluar për asetet e ngjashme të kompanisë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur, por ende të pa identifikuar. Lejimi për humbjet e përbashkëta është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për asetet e ngjashme financiare.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR(VAZHDIM)

Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të paraqitura si më poshtë:

Pasuritë afatshkurtëra	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,835	5,392
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	4,375,357	3,634,669
Stoku	2,143	2,357
Pasuritë tjera afatshkurtëra	1,883	750
Gjithësej pasuritë afatshkurtëra	4,382,218	3,643,168

3.5. Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatshkurte, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parashë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vrojtim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vrojtim. Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023, detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar(duke përfshirë pagesat e interesit, ku është e aplikueshme) të paraqitura si më poshtë:

Pasuritë afatshkurtëra	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,835	5,392
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	4,375,357	3,634,669
Stoku	2,143	2,357
Pasuritë tjera afatshkurtëra	1,883	750
Gjithësej pasuritë afatshkurtëra	4,382,218	3,643,168
Mbitërheqja bankare	95,260	92,302
Kreditë dhe Huatë	672,374	711,188
Llogaritë e pagueshme tregtare	775,918	646,781
Detyrimet tjera afatshkurtëra	121,679	1,188
Gjithësej detyrimet afatshkurtëra	1,665,231	1,451,459
Hendeku I Likuiditetit	2,716,987	2,191,709

Shumat e mësipërme pasqyrojnë rrjedhat e parave të gatshme të pa zbritura, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat bartëse të detyrimeve në datën e raportimit.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

4. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA OSE TË RISHIKUARA

4.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale të raportimit

- **SNRF 11** Ndryshimet në SNRF të (ciklit 2015-2019) rivlerësimi I intereist të mbajtur më pare hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 Janarit 2020);
- **SNK 12** Ndryshimet në SNRF të (ciklit 2015-2019) pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 Janarit 2020);
- **SNRF 16** Qeratë (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 Janarit 2020).
- **SNK 19** Amandamentet në lidhje me ndryshimet në planifikim, kufizimet ose rregullimet (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 Janarit 2020);
- **SNK 23** Ndryshimet në SNRF të (ciklit 2015-2029) kostot e huamarrjes të pranueshme për kapitalizim (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 Janarit 2020);

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Shoqërisë Tregtare.

4.2 Standardet dhe Interpretimet në përfundim që ende nuk janë efektive

- **SNRF 17** Kontratat e Sigurimeve (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”- Përcaktimi I një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së pare vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta”- Shitja ose Kontributi I Aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunitorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri sa metoda e kapitalit është përfunduar).
- Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet” – Përkufizimi I Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standard, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

5.Paraja dhe ekuivalentët e saj

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Paratë e gatshme	-	-
Paraja në bankë	2,835	5,392
Depozit afatshkurtra		
Gjithësej	<u>2,835</u>	<u>5,392</u>

Paraja ne banke ne fund te vitit 2025 eshte si ne vijim :

BPB Bank	1,037.15 €
PCB Bank	423.07 €
TEB Bank	1,120.81 €
NLB Bank	251.54 €
Banka Ekonomike (Kaçanik) .	1.29 €
Pri Bank	1.43 €

6.Llogaritë e arkëtueshme tregtare

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Llogaritë e Arkëtueshme	4,375,357	3,634,669
Gjithësej	<u>4,375,357</u>	<u>3,634,669</u>

7.Stoku

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Produktet e gatshme	2,143	2,357
Gjithësej	<u>2,143</u>	<u>2,357</u>

8.Pasuritë tjera afatshkurtëra

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Parapagimet e dhëna	1,883	750
Gjithësej	<u>1,883</u>	<u>750</u>

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturimave Pastërtia S.H.A.

9. Prona dhe Pajisjet

	Pajisje dhe Makineri	Ndertesa	Toka	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2024	2,335,727	306,803	1,274,860	3,917,390
Shtesa	21,202	-	-	21,202
Transferime Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,356,930	306,803	1,274,860	3,938,592
Shtesa	19,087	-	-	19,087
Transferime(shtje)	(120,035)	-	-	(120,035)
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	2,255,982	306,803	1,274,860	3,837,645
Zhveresimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2024	2,093,549	144,799	-	2,238,348
Zhlerësimi i vitit	20,199	14,648	-	34,847
Kthim zhveresimi	(493)	-	-	(493)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,113,255	159,447	-	2,272,702
Zhlerësimi i vitit	5,727	14,586	-	20,313
Kthim zhveresimi	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	2,118,982	174,033	-	2,293,015
Vlera neto kontabel				
Gjendja më 31 dhjetor 2024	243,675	147,356	1,274,860	1,665,891
Gjendja më 31 dhjetor 2025	137,000	132,769	1,274,860	1,544,630

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regionale E Mbeturimave Pastërtia S.H.A.

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
10. Kreditë dhe huatë afatshkurtëra		
Mbiterheqja bankare (Banke Ekonomike)	95,260	92,302
Gjithësej detyrime afatshkurtëra	95,260	92,302
11. Llogaritë e pagueshme tregtare		
Llogaritë e pagueshme tregtare	775,918	646,781
Gjithësej	775,918	646,781
12. Detyrimet ndaj tatimeve te pagueshme		
Detyrimet ndaj tatimeve te pagueshme	672,374	711,188
Gjithësej detyrime afatshkurtëra	672,374	711,188
13. Detyrimet tjera afatshkurtëra		
Detyrimet ndaj lëndëve gjyqësore	121,006	-
Detyrimet ndaj pagave	673	1,188
Gjithësej detyrime afatshkurtëra	121,679	1,188
14. Kapitali Aksionar		

Më 31 dhjetor 2025 kapitali aksionar është në vlerë prej 25,000 Euro (31 dhjetor 2024; 25,000 Euro).

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

15.Të Hyrat nga Shitja	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të hyrat nga Shitja	3,435,043	3,057,188
	3,435,043	3,057,188
16.Shpenzimet e personelit	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzimet Pagat Bruto	1,879,584	1,711,592
Shpenzimet e kontributeve pensionale	93,980	85,582
	1,973,565	1,797,174
17.Shpenzime të tjera operative	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e Derivateve Ferizaj	159,505	152,174
Shpenzimet e Derivateve Shtime	31,236	32,916
Shpenzimet Derivateve Kaqanik	32,527	32,489
Shpenzimet e Energjise Elektrike	2,884	5,413
Shpenzimet Deponise se Mbeturinave	376,798	316,059
Shpenzimet e mirembajtjes se automjeteve	97,399	82,402
Shpenzimet qerase	17,089	13,923
Shpenzimet zyres	25,425	25,467
Shpenzimet e automjeteve, taksave dhe sigurimeve	14,197	13,630
Shpenzimet e reres/krypes	5,957	-
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	8,224	7,618
Shpenzimet e reprezentacionit	2,736	3,329
Shpenzimet e marketingut	1,397	2,009
Shpenzimet e tjera te veprimtarise	150,600	70,540
Korrigjimi I llogarive te arketueshme	55,078	49,261
	981,052	807,230

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia SH.A.

18. Shpenzime financiare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzimet ndaj interesave dhe provizioneve	11,206	6,513
Shpenzimet tjera financiare	-	-
	11,206	6,513

19. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Tatimi në të ardhurat e korporatave është përfshirë në pasqyrat financiare në pajtim me legjislacionin tatimor në Kosovë: Ligjit nr.05-L029 për vitin 2025 dhe rregulloret tjera plotësuese aktuale sipas këtij ligji tatimi në fitim është 10%.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit	448,906	411,425
Shpenzimet e papranuara	-	-
Fitimi I tatueshem	448,906	411,425
Shpenzimet e tatimit ne fitim	(44,891)	(41,142)

20. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të kapitalit

Objektivat e Kompanisë për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e kompanisë që të vazhdoj aktivitetin mbi parimin e vazhdimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të zvogëluar koston e kapitalit.

Në mënyrë që të ruajë ose të përshtat strukturën e kapitalit, kompania mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar për aksionarët, kthimi i kapitalit tek aksionarët, të emetoj aksione të reja ose të shesë asete për të reduktuar borxhin.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
Kompania Regjionale E Mbeturinave Pastërtia S.H.A.

21. Transaksionet me Palët e lidhura

Palët e lidhura përfshijnë pronarët dhe drejtorët e kompanisë së bashku me entitetet të cilët kanë kontroll apo kanë ndikim në kompani.

22. Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

23. Ngjarjet pas periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë të pasqyrat financiare.

24. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më datën 20.02.2026

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ³ " Furnizim me Pajisje dhe Produkte për sigurimin dhe mbrojtjen e të dhënave në serverin; Furnizimi me vajra për nevojat e kompanisë; Furnizimi, montimi dhe riparimi i gomave për nevojat e KRM Pastërtia; Furnizimi me dy (2) automjete- (pickup) të përdorur për nevoja të kompanisë' dhe Furnizimi me një (1) kamionete të përdorur për nevoja të KRM Pastërtia".
- ⁴ KMDK në vlerë 459,366€; TELEKOMI në vlerë 10,673€; PAMKOS në vlerë 9,900€
- ⁵ Objekti i vjetër i drejtorisë, 32,809.57€; Kamion Mitcubishi, 30,000€; Ndertesa për inkasat dhe roja, 7,077,55€; Veture Citroen C5, 11,281,87€; Makine për shpërndarje kripes, 8,000€.
- ⁶ Sabri N Guri; Sami Hajdini; Nejaz Bunjaku; Ramiz Shabani; Ekrem Qorolli ; Zade Krraba; Fadil Haxhiu; Fadil Zagragja ; Agim Kombimore; Besnik Çerkini; Liridon Fazliu; Feim Krasniqi; Selim Krasniqi; Astrit Shala; Isen Qallaku; Feriz Ilazi; Hyzri Hysiqi; Sadri Berisha; Ekrem Haziri; Heset Vishi; Beqir Ahmeti; Njazi Tahiri; Mani Selimi; Xhavit Gashi; Albert Marevci.